

AKT – THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“SMART PROGRESS” SHPK

Në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe atij nr.9723, datë 03.05.2007 “Per Qëndrën Kombëtare të Biznesit”, me vullnetin tim të lirë unë nënshkruesi,

1. Z. Rajmond DERVISHI shtetas shiptar, i biri i Bashkim dhe Bajame, lindur në Vorë më 22.07.1981, banues në Tiranë, Rruga “Frosina Plaku” Ndërtesa 32, Hyrja 1, Apartamenti 11, Njësia Administrative Nr 7, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri, me numër karte identiteti I10722180Q, vendosa të zhvilloj veprimtari private e cila rregullohet nga kjo kontratë, Akti Themelimi dhe Statuti i saj gjithashtu dhe Legjislacioni në fuqi, si më poshtë vijon:

NENI 1

Formohet shoqëria tregtare e emërtuar “SMART PROGRESS” sh.p.k me ortak të vetëm themelues zotin: **Rajmond Bashkim DERVISHI**.

NENI 2

Shoqëria do të ketë statusin e nje shoqërie me pergjegjësi të kufizuar dhe do të përballoje humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin e regjistruar.

NENI 3

Shoqëria e ka selinë e saj në qytetin e Tiranës, Rruga “Frosina Plaku” Ndërtesa Nr.32, Hyrja 1, Apartamenti 11, Njësia Administrative Nr 7, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri. Ajo mund të çelë dhe seli të tjera, degë e filiale, përfaqësi e agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

NENI 4

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.


NENI 5

Shoqëria tregtare do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm (vetëm nëse është i përcaktuar):

Shoqëria tregtare mund të kryejë çdo aktivitet të lejuar me ligj në Republikën e Shqipërisë, mund të ushtrojë çdo veprimtari, e cila nuk ndalohe me ligj duke përfshirë por pa u kufizuar në to:

Konsulenca dhe ekspertiza tekniko ligjore në fushën e çështjeve të pronësisë. Përfaqësime ligjore dhe shërbime juridike, avokatie, përmbarimi, ndërmjetësimi për zhgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve në rrugë jasht gjyqësore. Agjensi imobiliare, blerje, shitje, marrje dhe dhënie me qira e në huapërdorje ose në çfardo lloj forme tjetër të ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit të pasurive të palujtëshme. Të blejë, financojë, investojë, të ofrojë shërbime dhe asistencë të të gjitha llojeve pa kufizim personave fizikë dhe juridik, të hyjë në marrëdhënie të ndryshme juridike duke përfshirë edhe pjesmarrje në kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera. Import-eksport, prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë artikuj të ndryshëm brenda teritorit të Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe jashtë saj, i të gjitha llojeve të mallrave industriale, ushqimore, bujqësore, blektorale, materiale ndërtimore, inerte, elektroshtëpiake, pajisje makineri, automjete të markave, llojeve dhe tonazheve të ndryshme, konfensione, artikuj të fushës së kozmetikës dhe të estetikës dhe të tjera pa kufizim. Tregti me shumicë dhe pakicë karburantesh, produkte të naftës dhe gazit natyror hidrocarbure të të gjithë llojeve, dhe bitum special.

Projektime urbanistike, arkitektonike, konstruktive, instalatorë, të veprave hidraulike, rrugë dhe hekurudha, ura dhe vepra arti.



AKT THEMELIMI

Projektme gjeodezike (topografike). Rilevime inxhinierike. Rilevime inxhinierike kadastrale. Sisteme GIS. Bazamente gjeodezike. Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

Studime gjeologo inxhinierike – hidrogjeologjike.

Projektimi i impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Projektme të sinjalizimit rrugor. Studime të sizmologjise inxhinierike vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

Studime e projektme të ndërtimit dhe mbylljes së venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta (urbane), kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

Studime e projektme të ndërtimit të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza, kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).

Projektim, zbatim, mbikqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit.

Vlerësim i pasurive të paluajtëshme për ndërtesa dhe tokë truall, për tokë bujqësore, tokë pyjore, kullote, livadh dhe toke të pafrytëshme si dhe linja teknologjike, makineri dhe pajisje.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis. Vlerësimi i demëve materiale, motorrike, të pronës dhe shëndetit.

Ushtrim i profesionit në ekspertiza private të zjarrfikëses në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtim, në hartimin, studimin dhe përgatitjen e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave të çdo lloji. Hartim i akteve të ekspertizës teknike për zjarret e rena.

Trajnim për dhënien e njohurive të mzsh-së.

Ushtrim i veprimtarisë së studim – projektimit dhe zbatimit në fushën e veprimtarisë minerare (kërkim-zbulimit, shfrytëzimit, përpunimit) dhe ndërtim punimesh nëntokësore në infrastrukturë për qëllime civile.

Auditim i brëndshëm në sektorin publik dhe në sektorin privat. Auditim i fondeve të Bashkimit Europian. Kontrolli tatimor dhe baza ligjore mbi të cilin kryhet kontrolli tatimor.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (Njëqindmijë) lekë dhe përbëhet nga 1 kuotë, nga e cila:

1. Z. Rajmond Dervishi zotëron 100% të kuotave.

Ndryshimi i kuotave bëhet nëpërmjet kontributeve në kapital ose me shitblerje.

NENI 7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve të ortakëve, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar që përcakton ligji.

NENI 8

Ortaku mund ti shesi kuotat e tij të kapitalit pjesërisht ose tërësisht. Shitja e kuotave, do të bëhet vetëm pasi të ketë marrë vendim asambleja e ortakëve me 100% të votave.

NENI 9

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

NENI 10

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- Asambleja e ortakëve.
- Administratori

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet në statut.

NENI 11

Administrator i shoqërisë “SMART PROGRESS” shpk emërohet Z. Rajmond DERVISHI, me afat 5 vjet, nga dita e regjistrimit të shoqërisë në QKB.

AKT THEMELIMI

NENI 12

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksioneve financiare do të kryhen në bazë të kriterëve të caktuar nga Banka e Shqipërisë. Shoqëria ka llogarinë e saj rrjedhëse, si dhe librin e saj të llogarive në bazë të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale.

NENI 13

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria i mbetet në përdorim të ortakut sipas përqindjes në kapital, mbasi të jenë likuiduar të gjitha detyrimet e të jetë hequr fondi i rezervës statutore.

NENI 14

Ky akt u përpilua nga ortaku i vetëm i shoqërisë duke shprehur vullnetin e tij të plotë e të lirë. Akti u përpilua me fuqi dhe në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare, për t'u depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë.

ORTAKU I VETËM THEMELUES

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“SMART PROGRESS” sh.p.k

RAJMOND BASHKIM DERVISHI

RAJMOND DERVISHI

Emër mbiemër (nënshkrimi)

U nënshkrua në Tiranë më 10.10.2024.